

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"ABCOM" sh.p.k.**



1. Sot me date 16/04/ 1998, ne Tirane

1. Altin LEKSANI, i biri i Avniut dhe i Agimes, lindur ne Tirane me 6 Maj 1971, banues ne Tirane, rruga Gjick Kuqali P. Ylli Kuq, mbajtes i leternjoftimit NF Nr.485581;

2. Aldo COBA, i biri i Kelit dhe Jelenes, lindur ne Tirane me 1/02/1968, banues ne Tirane, rruga Q. Stafa P.395 App.10, mbajtes i leternjoftimit nr. QH474219;  
dhe

3. Genti DACI, i biri i Janit dhe Marjetes, lindur ne Tirane me 25 Qershor 1972, banues ne Tirane, RR. M. Shyri P.54 , mbajtes i leternjoftimit QH Nr.321800;

vendosen te krijojne nje shoqeri te formes me pergjegjesi te kufizuar duke marre persiper detyrimet e meposhtme:

**2. Baza ligjore**

- 2.01 Shoqeria "ABCOM" Sh.p.k eshte person juridik shqiptar filluar qe nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.
- 2.02 Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me Ligjin "Per Shoqerite Tregtare", dhe legjislacionin e pergjithshem ne fuqi ne Shqiperi si dhe ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti.
- 2.03 Veprimtaria financiare e shoqerise zhvillohet ne perputhje me ligjin "Per Kontabilitetin".

**3. Forma**

- 3.01 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.)

**4. Selia**

- 4.01 Selia e Shoqerise eshte ne Rrugen Gjick KUQALI, P 4 shk.3 app.35/A Tirane.
- 4.03 Selia mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 4.03 Shoqeria mund te cele dege, filiale ose zyra perfaqesimi te saj si brenda territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera, ne perputhje me

legjislacionin e vendeve perkatese.

4.04 Vendimi per krijimin ose mbylljen e tyre merret nga Asambleja e Ortakeve.

## **5. Emertimi**

5.03 Emertimi i shoqerise eshte "ABCOM" sh.p.k. dhe ky emertim do te pasqyrohet ne tere dokumentacionin e brendshem si dhe ne korrespondencen e saj me te tretet.

5.04 Ndryshimi qe mund te pesoje emertimi, I nenshtrohet miratimit te Asamblese se Ortakeve.

## **6. Kohezgjatja**

6.03 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete 10 vjet.

6.04 Asambleja e Ortakeve gezon te drejten te prishe shoqerine ne cdo kohe kur veprimtaria e saj rezulton jo fitim prures. Ne kete rast, vendimi percakton edhe rregullat dh procedurat e likuidimit.

## **7. Kapitali**

7.03 Kapitali i shoqerise ne ditën e krijimit te saj eshte 100.000 (njqindmije) leke dhe eshte shlyer teresisht. Ai ndahet ne 100 pjese nga 1000 leke seicila.

7.04 Pjeset e kapitalit shlyhen nga ortaket si me poshte:

Ortaku Altin LEKSANI	34 pjese
Ortaku Aldo COBA	33 pjese
Ortaku Genti DACI	33 pjese

## **Objekti**

8.01 Objekti i veprimtarise se shoqerise do te perfshije kryesisht:

- \* Projektim, zbatim, administrim dhe konsulence te/per sistemeve te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te te dhenave dhe interkonektivitetit ne teresi;
- \* Perfaqesimin dhe ndermjetesim ne trasanksione tregtare dhe ne ate te sherbimit ne favor te shoqerive apo firmave te tjera qe operojne ne fusha te komunikimit dhe interkonektivitetit ne vecanti dhe ne fusha te ndryshme ne pergjithesi;


- \* Tregtim, montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike;
- \* Projektim dhe implementim te sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit;
- \* Ndjekje dhe kontroll i realizimit te projekteve;
- \* Konsulence teknike, ekonomike e juridike per specifikime teknike te rrjeteve dhe sistemeve te shkembimit te informacionit, per gara dhe siper marrje;
- \* Importim dhe instalim sistemesh dhe pajisjesh elektronike dhe te komunikimit.
- \* Import export te mallrave te ndryshem



## **9. Klauzola mbyllese**

9.01 Akti i themelimit u hartua ne shqip dhe u nenshkrua sot me date 16/04/98 nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

Ardo SONA  


Gentil Dani  


Altin Lehsani  


# **STATUTI** **I SHOQERISE "ABCOM" SH.P.K**



## **1. Themelimi**

- 1.01 Shoqeria "ABCOM" sh.p.k me poshte e quajtur shoqeri eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e perbere nga ortakët:

Altin LEKSANI, i biri i Avniut dhe i Agimes, lindur ne Tirane me 6 Maj 1971, banues ne Tirane, Rruga Gjick Kuqali P. Ylli Kuq, mbajtes i leternjoftimit NF Nr.485581;

Aldo COBA, i biri i Kelit dhe Jelenes, lindur ne Tirane me 01.02.1968, banues ne Tirane, Rruga "Q. Stafa", P.395 Ap.10, mbajtes i leternjoftimit Nr.QH474219;

Genti DACI, i biri i Janit dhe Marjetes, lindur ne Tirane me 25.06.1972, banues ne Tirane, Rruga "M. Shyri", P.54, mbajtes i leternjoftimit QH Nr.321800;

## **2. Baza ligjore**

- 2.01 Shoqeria "ABCOM" Sh.p.k. eshte person juridik shqiptar dhe e fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.
- 2.02 Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me Ligjin "Per Shoqerite Tregtare", dhe legjislacionin e pergjithshem ne fuqi ne Shqiperi si dhe ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti.
- 2.03 Veprimtaria financiare e shoqerise zhvillohet ne perputhje me ligjin "Per Kontabilitetin".

## **3. Forma**


- 3.01 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.)

## **4. Selia**

- 4.01 Selia e Shoqerise eshte ne Rrugen "Gjick KUQALI", P 4, shk.3, ap.35/A, Tirane.
- 4.02 Selia mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 4.03 Shoqeria mund te cele dege, filiale ose zyra perfaqesimi te saj si brenda territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera, ne perputhje me

legjislacionin e vendeve perkatese.

4.04 Vendimi per krijimin ose mbylljen e tyre merret nga Asambleja e Ortakeve.



## **5. Emertimi**

5.01 Emertimi i shoqerise eshte "ABCOM" sh.p.k. dhe ky emertim do te pasqyrohet ne tere dokumentacionin e brendshem si dhe ne korrespondencen e saj me te tretet.

5.02 Ndryshimi qe mund te pesoje emertimi, i nenshtrohet miratimit te Asamblese se Ortakeve.

## **6. Kohezgjatja**

6.01 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete 10 vjet.

6.02 Asambleja e Ortakeve gezon te drejten te prishe shoqerine ne cdo kohe kur veprimtaria e saj rezulton jo fitim prures. Ne kete rast, vendimi merret me shumicen absolute dhe percakton edhe rregullat e procedurat e likuidimit.

## **7. Kapitali**

7.01 Kapitali themeltar i shoqerise ne ditën e krijimit te saj eshte 100.000 (njeqindmije) leke dhe eshte shlyer teresisht. Ai ndahet ne 100 pjese nga 1000 leke secila.

7.02 Pjeset e kapitalit shlyhen nga ortaket si me poshte:

Ortaku Altin LEKSANI	34 pjese
Ortaku Aldo COBA	33 pjese
Ortaku Genti DACI	33 pjese

## **8. Transferimi i pjeseve te kapitalit**

8.01 Pjeset e kapitalit te shoqerise jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

8.02 Ortaket mund te transferojne pjeset e kapitalit ose te gjithë kapitalin te tretteve, por vetem pasi te jete ushtruar dhe refuzuar e drejta e parablerjes brenda teresise se ortakeve.

8.03 Ne te gjitha rastet, transferimi i pjeseve te kapitalit behet me akt noterial, perndryshe konsiderohet i pavlefshem.

## **9. Rritja e kapitalit**

9.01 Rritja e kapitalit behet me vendim te Asambles se ortakeve.

9.02 Vendimet e marra per qellimin e paragrafit te mesiperm, kerkojne nje shumice 3/4 votash dhe pjesemarrjen ne votim te te gjithe ortakeve.

## **10. Objekti**

10.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise do te perfshije:

- \* Projektim, zbatim, administrim dhe konsulence te/per sistemeve te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te te dhenave dhe interkonektivitetit ne teresi;
- \* Perfaqesimin dhe ndermjetesim ne trasanksione tregetare dhe ne ate te sherbimit ne favor te shoqerive apo firmave te tjera qe operojne ne fusha te komunikimit dhe interkonektivitetit ne vecanti dhe ne fusha te ndryshme ne pergjithesi;
- \* Tregtim, montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike;
- \* Projektim dhe implementim te sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit;
- \* Ndjekje dhe kontroll i realizimit te projekteve;
- \* Konsulence teknike, ekonomike e juridike per specifikime teknike te rrjeteve dhe sistemeve te shkembimit te informacionit, per gara dhe siper marrje;
- \* Importim dhe instalim sistemesh dhe pajisjesh elektronike dhe te komunikimit.
- \* Import export te mallrave te ndryshem

## **11. Vendimet e Asamblese se Ortakeve**

11.1 Asambleja e Ortakeve drejton shoqerine nepermjet marrjes se vendimeve te saj. Ajo merr vendim per ceshtjet e meposhtme:

- = ndryshimi i selise ose krijimi i selive te tjera;
- = ndryshimi i emertimit te shoqerise;
- = rritja e kapitalit;



- = kalimi i pjeseve te kapitalit te treteve;
- = prishja e shoqerise;
- = likuidimi;
- = shtyrja e kohezgjatjes;
- = emerimi i administratorit/administratoreve te shoqerise dhe percaktimi i kompetencave te tij/tyre si dhe shkarkimi i tij/tyre;
- = miratimi i bilancit;
- = transformimi i shoqerise ne forma te tjera.

11.2 Administrator i shoqerise do te jete Ortaku Altin Leksani, mandati i te cilit eshte nje vit. Ky mandat mund te zgjatet me shumicen e votave te Asamblese se Ortakeve.

11.3 Administratori kryen keto funksione:

- = Drejton veprimtarine e perditshme te shoqerise;
- = Organizon mbledhjet e Asamblese dhe pergatit materialet e rendit te dites;
- = Perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet;
- = Harton dhe mban kontabilitetin, emeron ekstpertet kontabel ne rast nevojje;
- = Nenshkruan dokumente dhe kontrata per emer dhe llogari te shoqerise, perjashtuar kontratat e huadhenies e te huamarrjes, te qirase e ato te qirase financiare, per te cilat procedohet me autorizim te Asamblese se Ortakeve;
- = Perfaqeson shoqerine para organeve shteterore lokale e qendrore si dhe para organeve gjyqesore. Kjo kopetence jepet me shkrim, rast pas rasti.

11.4 Per thirrjen e mbledhjeve te Asamblese se zakonshme ose te jashtezakonshme te Ortakeve, Administratori vepron mbi bazen e kerkeses se cdo ortaku si dhe me iniciative, kur e vlereson se thirrja e mbledhjes eshte e domosdoshme.

Administratori duhet ti njoftoje ortaket me shkrim te pakten 10 dite para dates se mbledhjes, duke percaktuar ne njoftim edhe rendin e dites.

11.5 Ortaket mund te marrin pjese ne mbledhje personalisht ose te perfaqesuar me prokure nga nje ortak tjetër ose nga te trete, te cileve mund t'u delegoje edhe te drejten e votimit ne emer dhe per llogari te tij.

11.6 Administratori mund te shkarkohet nga detyra edhe para skadimit te mandatit te tij njevecar, kur ne veprimtarine e tij konstatohen dhe provohen shkelje te renda te interesave te shoqerise ose/dhe tejkalim i kopetencave te percaktuara ne dispozitat e ketij statuti.

## **12. Konfidencialiteti**

- 12.1 Personat qe mund te punesohen nga Shoqeria marrin persiper te mos perhapin te dhena qe kane te bejne me natyren e veprimtarise se saj, me kontratat qe ajo lidh ose me projektet e synimet prespektive.
- 12.2 Mospermbushja e detyrimeve te parashikuara nga kjo klauzole i ben ata pergjegjes para shoqerise.

## **13. Aktet e Shoqerise**

- 13.1 Te gjitha aktet e dokumentet e shoqerise si fatura, dergesa, letra, njoftime, publikime etj., duhet te permbajne emertimin e shoqerise, dhe me pas shkurtimin e formes se shoqerise (sh.p.k.), adresen dhe emrin e administratorit.
- 13.2 Krahas ketyre dokumenteve, aktet e tjera te shoqerise do te jene te vlefshme per te tretet dhe shoqerine vetem ne rast se mbajne nenshkrimin e administratorit dhe vulen e shoqerise.

## **14. Viti financiar**

- 14.1 Ushtrimoret e shoqerise perputhen me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 janari e deri me 31 Dhjetor.
- 14.2 Perjashtimisht, ushtrimori i pare do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise ne zyren e tatim taksave dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 1998.

## **15. Kontabiliteti. Bilanci**

- 15.1 Kontabiliteti mund te mbahet nga administratori ose nga nje ekspert kontabel i emeruar prej tij.
- 15.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen shqipe e ne monedhe shqiptare. Per operacione te vecanta, shoqeria mund te beje veprime edhe me llogari te vecante ne monedhe te huaj, duke bere konvertimin brenda vitit financiar.
- 15.3 Bilanci vjetor i shoqerise shqyrtohet nga Asambleja e Ortakeve dhe duhet te pergatitet per t'u paraqitur para organeve tatimore deri ne fund te muajit mars te vitit ne vazhdim.

## **16. Fitimi, ndarja e tij**

- 16.1 Dividendi qe mund te rezultoj nga veprimtaria ekonomike pasi te jene llogaritur e zbritur tatimet e taksat, u kalon ortakeve ne menyre proporcionale, sipas pjeseve





qe kane ne kapitalin e shoqerise. Asamblea vendos edhe masen e fitimit qe mund te perdoret per ri-investim.

- 16.2 Ne rast se veprimtaria e vitit te pare rezulton me humbje, ato mund te zbriten nga fitimi i realizuar gjate tri ushtrimoreve pasardhes.

### **17. Likuidimi**

- 17.1 Ne rast se shoqeria priset me vendim te Asamblese se Ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e kapitalit te saj themeltar, ortaket vendosin edhe per menyren e likuidimit te saj.
- 17.2 Ne vendimin qe shpall prishjen dhe venien ne likuidim te shoqerise Ortaket, caktojne edhe likuidatorin ose likuidatoret, i cili/te cilet eshte/jane pergjegjes per kryerjen e te gjithave procedurave te nevojshme dhe per shlyerjen e detyrimeve ndaj kreditoreve. Pas shlyerjes se ketyre detyrimeve sipas radhes, pjesa qe mbetet u kalon ortakeve ne proporcion me pjeset e tyre ne kapitalin e shoqerise.

### **18. Punesimi**

- 18.1 Punesimi dhe marredheniet e punes do t'i nenshtrohen dispozitave te Kodit te Punes.


### **19. Mosmarreveshjet civile**

- 19.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve te shoqerise dhe midis shoqerise dhe te treteve e qe nuk zgjidhen me mirekuptim, mund t'i dergohen per shqyrtim gjykates kompetente shqiptare.

### **20. Klauzole mbyltese**

- 20.1 Statuti u hartua ne shqip dhe u nenshkrua nga perfaqesuesit e saj sot me date 16/04/98.

### **Ortaket Themelues**

ALDO SOBA  


Geneti Dani  


Altin Lekxmi  
